



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 664/8 prot.

Datë 25.03.2026

V E N D I M

Nr.425/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-69827-11-21-2025, me objekt: “Loti 1: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore””, me fond limit 14,118,523.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK, me NIPT K31523078F, dhe adresë Rruga Enriko Telini, Nd. 15, H. 1, Tiranë..

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.11.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-69827-11-21-2025, me objekt: “Loti 1: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore”, me fond limit 14,118,523.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 29.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 08.01.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Auto Manoku Servis	10,165,920 lekë	292.71 pikë	Kualifikuar
AEE Service	10,470,000 lekë	292.80 pikë	Kualifikuar
Servis - Auto 2000	10,196,500 lekë	0 pikë	Skualifikuar
Alstezo	12,800,000 lekë	229,40 pikë	Kualifikuar
Vilnik Motors	13,704,300 lekë	218,40 pikë	Kualifikuar

II.4. Në datën 14.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 16.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/202/6254 dhe nr.136/2026 prot, datë 16.01.2026 i operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-69827-11-21-2025, me objekt: “Loti 1: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore””, me fond limit 14,118,523.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 136/1 prot., datë 16.01.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 26.01.2026, autoriteti kontraktor, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 11/2026, datë 26.01.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Servis - Auto 2000” SHPK..Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Në datë 04.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.202/2026, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-69827-11-21-2025, me objekt: “Loti 1: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore””, me fond limit 14,118,523.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara..

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Në zbatim të vendimit Nr.202/2026, datë 04.02.2026 të KPP, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 18.02.2026, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

Servis - Auto 2000	10,196,500 lekë	299.28 pikë	Kualifikuar
AEE Service	10,470,000 lekë	292.80 pikë	Kualifikuar
Auto Manoku Servis	10,165,920 lekë	292.80 pikë	Kualifikuar
Alstezo	12,800,000 lekë	229,40 pikë	Kualifikuar
Vilnik Motors	13,704,300 lekë	218,40 pikë	Kualifikuar

II.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik të kualifikuar i pari “Servis Auto 2000” SHPK që të dorëzojë dokumentat e ofertës të ngarkuara në SPE, si dhe dokumentat provuese për të provuar vetdeklarimet e bëra në formularin e vetdeklarimit.

II.11. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 24.02.2026 ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ku rezulton se operatori ekonomik “Servis Auto 2000” SHPK, është skualifikuar me arsyen: “Operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” sh.p.k, Nipt K31523078F nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të kualifikimit pika 1, shkronja dh pasi nga verifikimi dokumentit Nr T14565028, Datë 21.11.2025 me emërtimin “Vërtetim për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore Për Tatimpaguesit – E-Sig 02/a i paraqitur në përmbushje të deklartës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit seksioni ku thuhet “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, konstatohet se nga të dhënat për kontributet te regjistruara në organin tatimor rezulton që subjekti “Servis - Auto 2000” sh.p.k, Nipt K31523078F ka për të paguar gjithsej 182,567 lekë detyrime. Referuar VKM Nr 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar nenit 26, pika 6 është dokument i detyrueshëm të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për vërtetimin e deklaratës së bërë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit seksioni ku thuhet “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së” ku të vërtetohet

që OE ka paguar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.. Për sa më sipër OE skualifikohet.”

II.12. Në datën 25.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.13. Në datën 02.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/202/6378 dhe nr.664/2026 prot, datë 02.03.2026 i operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-69827-11-21-2025, me objekt: “Loti 1: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore”, me fond limit 14,118,523.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vleresimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.14. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 664/1 prot., datë 03.03.2026.

II 15. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 10.03.2026, autoriteti kontraktor, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 43/2026, datë 10.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, protokolluar me tonën me nr.664/2 prot., datë 10.03.2026, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Servis - Auto 2000” SHPK..Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.16. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.3901/22 prot., datë 10.03.2026, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Servis Auto 2000” SHPK , lidhur me vlerësimin në procedurën” , protokolluar me tonën me nr.664/3 prot., datë 11.03.2026, ka përcjellë pranë KPP vendimin e KSHA nr. 43/2026, datë 10.03.2026 në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Servis - Auto 2000” SHPK, si dhe dokumentacionin e paraqitur prej këtij të fundit në autoritetin kontraktor.

II.17. Me shkresën nr.664/3 prot., datë 11.03.2026 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacionin si më poshë: [...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar në KPP informacion për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, por autoriteti kontraktor duhet të dërgojë **kopje të njësuar me origjinalin** të dokumentacionit me Nr T14565028, Datë 21.11.2025 me emërtimin “Vërtetim për kontributet e Sigurimeve

Shoqërore e Shëndetsore Për Tatimpaguesit – E-Sig 02/a të paraqitur nga operatori ekonomik “ Servis - Auto 2000” SHPK pranë autoritetit kontraktor, si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.[...].

II.18. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.3901/24 prot., datë 17.03.2026, me objekt “Dërgim dokumentacioni...”, protokolluar me tonën me nr.664/5 prot., datë 19.03.2026, ka përcjellë praë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “ *Operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” sh.p.k, Nipt K31523078F nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të kualifikimit pika 1, shkronja dh pasi nga verifikimi dokumentit Nr T14565028, Datë 21.11.2025 me emërtimin “Vërtetim për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore Për Tatimpaguesit – E-Sig 02/a i paraqitur në përmbushje të deklartës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit seksioni ku thuhet “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, konstatohet se nga të dhënat për kontributet te regjistruara në organin tatimor rezulton që subjekti “Servis - Auto 2000” sh.p.k, Nipt K31523078F ka për të paguar gjithses 182,567 lekë detyrime. Referuar VKM Nr 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar nenit 26, pika 6 është dokument i detyrueshëm të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për vërtetimin e deklaratës së bërë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit seksioni ku thuhet “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së” ku të vërtetohet që OE ka paguar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.. Për sa më sipër OE skualifikohet.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 1/dh, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

....

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Ndërsa në pikën 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.b të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues për lotin 1, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

• Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të plotësuar dhe nënshkruar, ku për kriterin 1/dh ka deklaruar:

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve :www.e-albania.al/
Vertetimet për pagim detyrimesh/vertetimet për pagim kontributesh e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për tatim paguesin-Esig-sig02/a

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.4 Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në

legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një

marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të

mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepr penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.1.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPPsë, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërket të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me

originalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.10. Nisur nga pretendimet e ankimuesit për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se : *“nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të kualifikimit pika 1, shkronja dh pasi nga verifikimi dokumentit Nr T14565028, Datë 21.11.2025 me emërtimin “Vërtetim për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore Për Tatimpaguesit – E-Sig 02/a i paraqitur në përmbushje të deklartës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit seksioni ku thuhet “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, konstatohet se nga të dhënat për kontributet e regjistruara në organin tatimor rezulton që subjekti “Servis - Auto 2000” sh.p.k, Nipt K31523078F ka për të paguar gjithsesi 182,567 lekë detyrime...”*, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 1/dh të Shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për lotin 1, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit deklaron se dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;... Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 10.**

Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit (përfshi dhe kriterin 1/dh) dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ka kryer deklarimet në këtë formular. Si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ankimuesi ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor ndër të tjera dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të mësipërm, dokumente, të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr.3901/22, datë 10.03.2026, me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Servis Auto 2000”...”, protokolluar me tonën me nr. 664/3 datë 11.03.2026 dhe shkresën nr.3901/24 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 664/5 datë 19.03.2026, bashkë me dokumente të tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e kriterit të përgjithshëm 1/dh për kualifikim, dokumenti Nr T14565028, Datë 21.11.2025 me emërtimin “Vërtetim për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore Për Tatimpaguesit – E-Sig 02/a. Nga verifikimi i këtij dokumenti provues, në funksion të kriterit 1/dh të kriterëve të përgjithëshme të kualifikimit, i cili është deklaruar në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe i dorëzuar në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik ankimues si i kualifikuar i pari rezulton se, ky dokument nuk është i rregullt.

Së pari, në këtë dokument konstatohet se kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, dhe shëndetsore të muajit nëntor 2025 nuk janë likuiduar, edhe pse është muaj i maturuar për pagesë, referuar nenit 11, gërma “a” të ligjit nr.9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se” Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme: a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;”, si dhe datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi 29.12.2025,

Së dyti pagesat (kontributet interesat) e muajit tetor 2025 janë në vlerën 0 lekë dhe në këtë vërtetim citohet se: “Nga të dhënat për kontributet e regjistruara në organin tatimor deri në datën 21.11.2025, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 21.11.2025, rezulton që ky subjekt ka për të paguar gjithsej 182,567 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej 182,567 lekë, kamatvonesa për kontribute 0 lekë, gjoba lidhur me kontribute 0 lekë”.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni provuese (vërtetimi Nr T14565028, Datë 21.11.2025), i paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Servis 2000” SHPK, si provë e deklarimit të bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterit 1/dh të kriterëve të përgjithëshme për kualifikim, duke qenë se rezulton me detyrime në vlerën 182,567 lekë dhe nuk vërteton shlyerjen e detyrimeve të muajit nëntor 2025, nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë

20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-69827-11-21-2025, me objekt: “Loti 1: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore”, me fond limit 14,118,523.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara..
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Servis - Auto 2000” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

